

KOMUNA MAQELLARË

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT





Bardhyl Agolli - Kryetar i komunës Maqellarë

MESAZHI I KRYETARIT TE KOMUNES MAQELLARE

Komuna Maqëllarë është më e madhja në Qarkun e Dibrës dhe ndër më të mëdhat në vend, për nga numri i popullsisë. Që në fillim të viteve '90 e në vazhdim në të gjitha fshatrat e saj (22 fshatra), janë kryer investime të ndryshme, si në rrugë, kanalizime të ujrave të bardha e kanalizime të ujrave të zeza, arsim, shëndetësi si dhe shumë shërbime të tjera në të gjithë infrastrukturën e saj. Të gjitha këto investime e shërbime kanë ndikuar jo pak, në mirëqënien e përgjithshme në tërësi dhe të qytetarit në veçanti, çka është shumë e evidente sot.

Megjithatë, koha ecën me ritme të shpejta dhe Komuna Maqëllarë si më e zhvilluara në Dibrë, e ka ndër të këta. Kërkesat e qytetarëve janë rritur në një stad të ri, po kështu edhe nevojat për investime e shërbime kanë ndryshuar. Tashmë nuk mund të flitet më për investime të vogla e me afat të shkurtër, nuk mund të flitet për plotësim kushtesh e nevoja të çastit, por duhet krijuar një strategji e qartë për atë se çdo të bëjë Komuna Maqëllarë në të ardhmen. A do të jetë ajo përsëri në pararojë të zhvillimit e mirëqenise? Cilat do të jenë sfidat e zhvillimit dhe përparimit të saj? Çfarë rrugësh duhen ndjekur? ...etj.

Për këtë Komuna Maqëllarë në mbështetje të mendimit qytetar, të komunitetit, filloi të mendoj për të hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit të saj.

Plani Strategjik i duhet patjetër Maqëllarës, sepse do të orjentojë shumë qartë Komunën Maqëllarë, për atë se ç'ka do të bëjë në të ardhmen. Me këtë synim Komuna Maqëllarë, me mbështetje të Këshillit të Qarkut Dibrë (Njësia trajnuese) dhe S.N.V. Dibrë, filloi hartimin e tij dhe pas një pune disa mujore ai u përfundua me sukses. Në këtë plan janë pasqyruar, historia e trevës sonë, gjeografia e saj me një pozicion gjeografik shumë të përshtatshëm si një urë lidhëse mes Dibrës së Madhe, Peshkopisë dhe Tiranës.

Në këtë plan zhvillimi pasqyrohet qartë, popullësia e Maqëllarës, ekonomia, burimet natyrore, arsimi, shëndetësia, infrastruktura në përgjithësi, bujqësia, blegtoaria, biznesi etj. Ajo çfarë është arritur dhe ajo që do të arrihet në të ardhmen. Ky plan tregon qartë se çfarë do të bëhet në Maqëllarë në prespektiv dhe për këtë janë marrë mendimet, kërkesat e vizioni i shumë shtresave të popullsisë të komunitetit të Maqëllarës.

Vizioni ynë për të ardhmen është ta shohim Maqëllarën *Bashki*, me rrugë të gjëra të asfaltuara, me gjelbërim në rritje çdo ditë, me zhvillim të fuqishëm të biznesit, me rritje të mirëqenies ekonomike për çdo familje e banor të saj, me përmirësim rrënjësor të infrastructures, në çdo fshat e në të gjitha fshat.

Maqëllarën e shohim me ujë të pijshëm të garantuar, Kanale të Ujrave të Zeza e Kanale te Ujrave të Bardha të përfunduara, me rrugë fshatrash që asfaltohen e me një popullësi që mendon të mos braktis kurrë atë.

Por kjo nuk mund të realizohet vetëm në letër. Për të përmbushur objektivat e këtij Plani Strategjik, duhet angazhim total, duhen fonde të caktuara, duhet mund e djerës dhe për këtë, në rradhë të parë kemi mbështetjen e komunitetit. Me angazhimin e tij, me përkushtimin e drejtuesve të Komunës si dhe mbështetjen e Qeverisë dhe donatorëve të ndryshëm.

Duke falenderuar grupin e punës, S.N.V Dibrë dhe Këshillin e Qarkut Dibrë, jam i bindur në përkushtimin tonë të përbashkët, për të ndryshuar e zhvilluar çdo ditë Maqëllarën tonë të bukur e begatë, vendin e njerëzve të kulturës, të dijes, në vendin e zhvillimit të vullshëm ekonomik, në një vend të mrekullueshëm për të jetuar.

PERMBAJTJA

1. Fjala e kryetarit
2. Tabela e permbajtjes
3. Profili i komunës
 - a. Komponenti social
 - i. Pozita gjeografike,
 - ii. Pak histori, popullsia
 - iii. Arsimi
 - iv. Shërbimi shëndetsor
 - b. Ekonomia lokale
 - i. Situata e përgjithshme
 - ii. Burimet natyrore
 - iii. Bujqësi dhe blegtori
 - iv. Industria
 - c. Infrastruktura dhe shërbimet
 - d. Qeverisja vendore
 - i. Struktura e komunës
 - ii. Analiza e gjendjes
4. Vizioni; strategjite sektoriale
5. Realizueshmeria



PROFILI I KOMUNES

POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Maqellares eshte njesi administrative me e madhe ne Qarkun Dibres dhe nder 10 komunat ne vend. Ajo Kufizohet *ne veri* me Komunen e Melanit, *ne lindje* dhe *ne jug* me Republikën e Maqedonise, *ne perendim* me Komunen e Shupenzes dhe Komunen e Gjorices. Ne Perendim pershkohet nga lumi Drini i Zi. Maqellara ka relief fushor, kodrinor dhe malor, kuota me e ulet e relievit ndodhet ne Gradec me lartesi rreth 410 m mbi nivel te detit, ndersa kuotat me te larta jane Maja e Kerçinit me lartesi 2343 m dhe Maja e Velivarit 2374 m. Maqellara eshte nje nyje lidhese mes Dibres se Madhe dhe rrethit Diber, mes Dibres se Madhe dhe Tiranës, Durresit dhe gjithë Shqiperise. Ka burime te shumta natyrore. Klima, ne stinen e veres eshte e nxehte dhe e thate, ndersa dimri, eshte i ashper, me rreshje debore e lageshtire. Ne arterien kryesore te kesaj rruge Tirane – Peshkopi dhe *Bllate(dogana) – Peshkopi* e cila siguron nje komunikim me te gjithë rrethin e Dibres dhe Shqiperine ne aksin rrugor Bllate –Maqellare – Tirane. Ka nje siperfaqe te pergjithshme 87.3 km². Popullsia arrin ne 14000 banore e shperndare ne 22 fshatra: Maqellare, Burim, Potgorce, Çernene, Vojnike, Fushe eVogel, Kovashice, Gradec, Dovolani, Erebare, Herbel, Grazhdan, Pesjake, Popinare, Katund i Vogel, Pocest, Kerçisht i Eper, Kerçisht i Poshtem, Kllobçisht, Bllate e Eper, Bllate e Poshtme, Majtare.

PAK HISTORI

Maqellara ka qene e banuar qe ne lashtesi, kjo bazuar ne gjetjet e arkeologeve. Nga studimet arkeologjike jane gjetur rrenoja vendbanimesh te hershme dhe mbetjet e relikeve te gjetura. Vendbanimet parahistorike perfshihen qe nga neoliti i hershem(6000 vjet) para Krishtit e deri ne ditet e sotme. Vlen te permendet Vendbanimi I pare ne Diber ne epoken e Gurit(neolit i hershem 6000 -2000 vjet p.e.s.) eshte fshati Burim. Ne vazhdimesi ka patur vendbanime te para si ne Grazhdan (edhe sot kemi renojat e kalase), Herbel, qyteti i Pesakut (vendbanim i hapur ne jug te fshatit Kllobçisht te sotem), Ara e livadhit te Madh (vendbanim ne Burim), gradishta e Vojnikes(vend Prehistorik dhe Antik i vone).

Ne Maqellare, Historia tregon qe ne koherat e lashta kjo komune ka qene e banuar dhe per kete vlen te permenden toponimet te cilat lidhen me

emertimet e fshatrave dhe vendeve te tjera. Nje dokument arkivor i shkruar per here te pare per regjistrimin e popullsise se Dibres i vitit 1467, i Defterit Turk tregon emrat e fshatrave te Komunes se Maqellares me numrin e familjeve per çdo fshat, si meposhte:

Nr	Emertimi I fshatit sipas Defterit Turk te vitit 1467	Identifikimi i emrit te atehershem me fshatrat e sotem	Nr. i shtepive ne vitin 1467
1	Kurna Kerçishta	Kerçisht i Eper	19
2	Potestasi	Pocesti	9
3	Kllobçisht	Kllobçisht	11
4	Masitara	Majtare	4
5	Maqellare	Maqellare	7
6	Kavoççe	Kovashice	5
7	Dolna Kerçisht	Kerçisht i Poshtem	13
8	Hobok	Katund i Vogel	3
9	Harbil	Herbel	5
10	Rinbari	Erebare	11
11	Rahmani	Reshani (Bllate e Poshtme)	2
12	Belato	Bllate e Eper	6
13	Çirvani	Çernene	15
14	Gratulani	Grazhdani	-
15	Gradec e Çiok	Gradec dhe Qenok	-
16	Dovoljani	Dovolani	6
		Shuma:	116

Maqellara ose fusha e Shehrit, gjate gjithë historise se saj ka qene e lidhur me zhvillimet ekonomike, sociale dhe politike me Dibren e madhe, ose shehri sic njihet ne gjuhen e folur, qe padrejtesisht u nda nga kufijte shtetror duke e lene brenda kufijve te ish republikes Jugosllave te Maqedonise.

Banoret e treves se maqellares, shquhen per njerez punetor, te qyteteruar, arsimdashës dhe qe kane marre pjese ne evenimente kryesore historike te popullit Shqiptar. Permendim ketu kuvendin e Dibres qe ishte pergaditja e lidhjes shiptare te Prizrenit dhe Iljaz Pashe Qoku – Dibra ishte kryesuesi i saj. Figura te tjera te shquara kane dale nga kjo treve si profesioniste ne fusha te ndryshme, artiste, profesore dhe politikan me peshe si: Ismail Strazimiri prefekt ne qeverine e pare shqiptare, Ramiz Daci deputet i parlamentit te pare, Fiqiri Dine kryeminister etj.



POPULLSIA

Maqellara ka nje popullsi prej 14000 banoresh e perqendruar ne 22 fshatrat e komunes. Levizjet demografike te cilat jane karakteristike per rajonin e Dibres, per komunen e Maqellares ka qene me e ulet ne krahasim me komunat e

tjera, por qe keto 5 vitete e fundit ka pasur nje tendence ne ulje ose mund te themi qe ka nje stabilitet. Kryesisht levizja ka pasur tendencen drejt qendres metropolitane ne Tirane e Durres.

EMIGRIMI

Siç shihet edhe nga tabela del qe ne komunen tone ka nje numer shume te madh te emigranteve te cilet perfshijne moshat nga 18-40vjeç. Rreth 75 % e tyre punojne ne Itali, 20 % ne Greqi dhe 5 % ne Angli, France Gjermani e vende te tjera. Keto i japin nje zhvillim shume te madh komunes, por mundesite e investimeve nga te ardhurat e emigranteve jane te kufizuar. Nje pjese e tyre kane marre edhe familjet çka perben nje rrezik te madh per te sjelle te ardhura ne vendin e tyre


Nepermjet tabelave te meposhtme, jepet karakteristikat kryesore te popullsisë, mosha, gjinia, niveli arsimor, punesimi, papunesia dhe numri i pensionistëve dhe personave qe trajtohen me ndihme ekonomike.

TE DHENA DEMOGRAFIKE SIPAS QENDRAVETE BANUARA

Nr	Fshati/Lagjia	Nr. i banoreve			Nr. i familjeve ne vitet		Nr. i pensionistëve	Nr. fam. qe marrin ndihme soc.
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	2002	2007		
1	Maqellare	629	660	1289	241	297	204	71
2	Burim	479	463	942	201	204	109	53
3	Potgorce	140	148	288	54	63	31	16
4	Çernene	244	247	491	106	106	41	31
5	Vojnike	377	338	715	148	171	94	38
6	Kovashice	255	279	534	115	112	65	38
7	Gradec	42	59	101	37	36	16	8
8	Fushe e Vogel	134	146	280	69	70	44	17
9	Dovolani	182	274	456	134	126	53	34
10	Erebare	313	353	666	140	147	80	59
11	Herbel	170	160	330	87	82	31	15
12	Grazhdan	300	326	624	162	155	75	39
13	Popinare	118	119	237	45	46	20	13
14	Pesjake	115	107	222	47	41	24	15
15	Katund I Vogel	382	349	731	152	132	74	47
16	Pocest	722	754	1476	307	314	138	100
17	Kerçisht I Eper	157	176	333	85	78	35	23
18	Kerçisht I Poshtem	373	499	872	183	186	106	40
19	Killoçisht	650	649	1299	234	236	139	81
20	Billate e Eper	162	171	333	69	65	30	7
21	Billate e Poshtme	237	242	479	98	101	62	21
22	Majtare	428	408	829	150	165	77	31
	Njesia (Total)	6609	6920	13529	2864	2933	1548	800

PUNESIMI


Aktive		Te punesuar		Te papunesuar		Shkalla e Papunesise	
Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
3406	3846	1018	3061	2388	785	70 %	21%



TE PUNESUAR SIPAS SEKTOREVE

Lloji i aktivitetit	Sektori Privat			Sektori Publik			Gjithsejt		
	Nr.Sub	Te punesuar	Gra	Nr.Sub	Te punesuar	Gra	Gjith sub	Gjith punesuar	Gjith Gra
1 Bujqesi & Blektori	2200	4108	894	2	5	-	2202	4110	899
2 Ndertim	6	14	-				6	14	-
3 Tregtia, riparimi automob. dhe artikujve shtepiak	86	86	5				86	86	5
4 Hotele dhe restorante									
5 Transporti dhe telekomunikacioni	12	12	-				12	12	-
6 Aktivitete financiare (banka)									
7 Administrimi publik				3	35	2	3	35	2
8 Arsimi				6	149	78	6	149	78
9 Shendetet dhe veprimtarite sociale				1	39	39	1	39	39
Totali	2304	4212	899	12	223	119	2316	4435	1018

GRAFIKU I BURIMEVE TE PUNESIMIT



BURIMET NJEREZORE

Nr	Emertimi	Gjithsej	Te punesuar	Te pa pune
	Me Arsim te larte	113	91	22
1	Ekonomist	12	8	4
2	Agronome	7	5	2
3	Inxhinjere	2	2	-
4	Mesues	72	60	12
5	Mjek	4	4	-
6	Te te tjere	16	12	4
	Gjithsej	226	182	44
	Me Arsim te mesem	200	130	70
1	Ekonomik	15	5	10
2	Agronom	150	-	150
	Te pergjithshem	235	30	205
	Gjithsej	600	165	435

ARSIMI


Ne komunen e Maqellares arsimimi realizohet nepermjet:

- arsimet parashkollor,
- arsimet te ciklit te ulet,
- arsimi nentevjecar, dhe
- arsimin e mesem te pergjithshem.



Ne tabelle, jepet informacion i pergjithshem per numrin e nxenseve dhe te shkollave.

Arsimi ne vite	Nr. shkollave 9-vjecare	Nr. nxenes	Nr. shkollave te mesme	Nr. nxenes	Nr. kopshte	Nr. femijeve	Nr I Mesuesve dhe Edukatoreve (Total)
2007	5	2030	1	322	17	407	151
2005	5	1956	1	308	17	395	153



Me gjithese me tradite te mire ne kete drejtim, ku jane nje plejade e madhe njerezish te mirearsimuar dhe sidomos me arsim te larte, kushtet per zhvillimin e arsimit kerkojne masa dhe orientime te reja per te qene me cilesor dhe sipas standartave Europiane dhe te krahasuar me nivelin me te mire ne vend.

Nje shkollë e mesme dhe 5 shkolla 9 – vjecare, ne te cilat Komuna ka bere shume investime, por akoma ka nevojë per investime. Gjithashtu mungesa e kabineteve, e bankave, e laboratoreve, e mjeteve shkollore, e mjediseve sportive lenë shume per te deshiruuar.

Largesia e madhe mes fshatrave, ka sjelle probleme me frekuentimin e shkollave, pasi pjesa e madhe e nxenesve shkojne me kembe neper shkolla.

SHERBIMI SHENDETESOR

Shifra dhe fakte te pergjithshme:

Fshati/lagjia	Qendra Shendetesore	Ambulanca
1 Maqellare	1	1
2 Burim		1
3 Potgorce		
4 Çernene		1
5 Vojnike		1
6 Kovashice		1
7 Gradec		
8 Fushe e Vogel		
9 Dovolani		1
10 Erebare		1
11 Herbel		1
12 Grazhdan		
13 Popinare		
14 Pesjake		
15 Katund i Vogel		1
16 Pocest		2
17 Kerçisht i Eper		1
18 Kerçisht i Poshtëm		1
19 Kllobçisht		2
20 Bllate e Eper		1
21 Bllate e Poshtme		1
22 Majtare		1
Komuna	1	18


Sherbimi Farmaceutik

Fshati	Farmaci nr
1 Maqellare	2



Vdekshmeria foshnjore te femijeve 0-1 vjeç

Komuna	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
	2.2%	2.1%	2%	2%	1.8%	1.75%	1.7%	1.7%	1.6%	1.6%



Vdekshmeria amesore

Komuna	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
	0.5%	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Vaksinimet ne %

Komuna	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
	97%	97%	97%	97%	97%	97%	97%	97%	97%	97%

Personeli mjeksor

Fshati/lagjia	Nr.Mjekeve	Banore/Mjek	Nr.Infermjereve	Banore/Infermjere
I Maqellare	4	4523	35	385


Shperndarja e mjekeve sipas specialiteteve

Specialiteti	Nr
I Pergjithshem	4
Total Komuna	4

Kujdesi per shendetin publik eshte pergjegjesi e perbashket mes pushtetit lokal dhe qendror. Pavarsisht se ky sistem shendetsor perfshin ate paresor, spitalor dhe farmaceutik, ai paresor ose ambulator perfaqeson pjesen me te rendesishme dhe me te prekshme per popullaten. Keshtu sherbimi ndaj nenes e femijes si dhe urgjencat jane me te domosdoshmet dhe me te nevojshemet.

Ne Maqellare ekziston nje spital dhe nje qender ambulatore kryesore, ku mund te themi qe jane ne gjendje te mire por te pa mjaftushme per gjithte popullaten e 22 fshatrave te komunes. Qe kane qendra ambulatore, duke marre ketu ne konsidrate dhe shtrirjen e madhe gjeografike.

Personeli eshte i specializuar por qe kerkon nje shtim te numrit te tij dhe kualifikim te metejshe, pasi kryesisht mjeket sapo marrin nje specializim ato largohen apo e ndryshojne pozicionin e punes.



Deget kryesore te konomise jane bujqesia, blektoria dhe sherbimet, kryesisht e perqendruar ne bare dhe restorante.


BIZNESET

Në komunën tonë ushtrojnë aktivitetin e biznesit te vogel rreth 104 subjekte ne keto lloje aktivitetesh;

Sherbime artizanale, farmaci, farmaci bujqesore, bar-bufe, riparim TV, perpunim druri, materiale ndertimi, stomatolog, thertore, tregeti ushqimore, artikuj industrial etj. Te ardhurat nga biznesi zene nje mase te konsiderueshme ne buxhetin e komunes. Mbetet per tu perqendruar puna ne regjistrimin e bizneseve te reja, ne pagesen e takses mbi pasurine e paluajtshme si taksa mbi ndertesat dhe taksa mbi token bujqesore.

Te ardhurat e mbledhura dhe te parashikuara:



Emertimi	Totali I te ardhurave ne 2006	% qe shkon ne komune	Parashikim 2007
I. Te ardhura nga taksat			
1. Takse mbi pasurine e paluajtshme	1 073 000	100 %	950 000
2. Taksa mbi biznesin e vogel	2 128 000	100 %	3 500 000
A) Taksa vendore mbi biznesin e vogel	2 128 000	100%	3 500 000
3. Taksa per regjistrimin e pervitshem te automjeteve te transportit	823 000	88 %	900 000
4. Taksa te tjera	1 987 000	100 %	1 310 000
SHUMA I	6 011 000		6 660 000
II. Te ardhura jo tatimore			
I. Tarifa			
a) Tarifa per sherbime publike			
b) Dhenie e licensave, leje, autorizime e leshimi i dokumentave te tjera	177 000	100 %	160 000
2. Te ardhura te tjera	273 000	100 %	180 000
3. Pagesa			
a) Te prinderve per kopshtet e femijeve			
b) Te prinderve per çerdhet e femijeve			
c) Te tjera			
SHUMA II	450 000		340 000
III. Kontribute dhe sponsorizime			
SHUMA III			
TOTALI (I + II + III + IV + V)	6 461 000		7 000 000



Sherbimet Publike dhe Infrastruktura


Nr	Viti	Transferta (granit) nga Buxheti i shtetit	Fonde te kushtezuara nga Qeveria (ministrite)	Te ardhurat e vete Komunes nga taksat/tatimet/tarifa	Donatoret/Sponsorizime
1	2003	14 648 000	108 465 000	6 657 000	
2	2004	16 985 000	108 875 000	4 932 000	
3	2005	25 381 000	114 582 000	7 670 000	
4	2006	34 432 000	121 574 000	8 329 000	
5	2007	30 881 000	111 539 797	7 000 000	

Paraqitja grafike e burimeve te te ardhurave ne 000/leke



I. Investimet e bera ne Njesi ne vitet 2003 – 2007

	Me te ardhurat e komunes + granti	Fonde te tjera nga Buxheti i Shtetit	Me donacione	Me kredi	Total
2003	3 563 539				
Per shkolla					
Per Rruge	2 895 390				
Per ujesjellesa					
Per kanalizime	668 149				
Per tregje					
2004	3 430 405				
Per shkolla					
Per Rruge	2 435 122				
Per ujesjellesa					
Per kanalizime	995 283				
Per tregje					
2005	8 035 870				
Per shkolla					
Per Rruge	1 587 426				
Per ujesjellesa	796 344				
Per kanalizime	5 652 100				
Per tregje					
2006	14 133 589				
Per shkolla					
Per Rruge	6 590 016	4 736 700			
Per ujesjellesa	640 284				
Per kanalizime	6 905 389	5 974 593			
Per tregje					



SHPENZIMET 2006				
Funksionet	Totali	Inv. Nga te ardhurat	Inv.nga B.Shtetit	Inv.nga Donator.
1.Administrata e pergjithshme	40 365 000	500 000	14 763 000	
2.Sherbime publike				
3.Arsimi	63 733 000			
4.Shendetesia	14 468 000			
5.Kultura				
6.Çeshtje sociale	41 502 000			
7.Te tjera(Gj.Civile)	407 000			
Nga keto:Fondi rezerve	160 000			
TOTALI	160 635 000	500 000	14 763 000	

PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE 2007				
Funksionet	Totali	Inv. Nga te ardhurat	Inv.nga B.Shtetit	Inv.nga Donator.
1.Administrata e pergjithshme	39 964 000	7 270 000	9 643 000	
2.Sherbime publike				
3.Arsimi	60 958 709			
4.Shendetesia				
5.Kultura				
6.Çeshtje sociale	40 398 844			
7.Te tjera(Gj.Civile)	236 244			
Nga keto:Fondi rezerve	863 000			
TOTALI	142 420 797	7 270 000	9 643 000	

BURIMET NATYRORE

Komuna e Maqellares ka burime natyrore te pasura e te shume llojshme. Duke ofruar nje pejsazh te bukur me nje nderthurje te rralle te fushes, kodrinave te buta e deri tek bjeshket e Kerçinit dhe Valivarit, me pyje e kullota masive, me ujra siperfaqesore e nentokesore te bollshme e cilesore, me masive shkembore si Kepi i Kerçinit, Guri i Erebares, Ujvares se Pocesit, qe i japin variacion ne forme e ne ngjyre ketij pejsazhi, kjo natyre e begate, te fton e te ben optimist per mundesite e zhvillimit te kesaj komune.

Maqellara ka siperfaqe te konsiderueshme me pyje si: ah, pishë, bredh, akacie dhe me livadhe e kullota qe gjenden ne lartesi te ndryshme, e cila ka një bukuri natyrore mbreslënëse. Ata ndikojne pozitivisht ne mbrojtjen e tokes nga erozioni, dhe ne te njejtën kohe sigurojne lende drusore per djegie, ndertim etj. Në këto pyje rriten shumë bimë medicinale si: Dëllinja, Trëndafili i egër, Çaji i malit, Mëllaga, Lule Basani, Lule Shtogu, Qershigla etj. Duke patur plote pervoje kjo treve ne kultivimin e frutikultures ne zone kemi plote banore qe ne feramat e tyre kultivojne molle, qershi, kumbull,

dardhe, rrush si geshtenje dhe arrë e cila është e një lloji të veçantë dhe shumë e preferuar nga konsumatorët.

Rreth 89 ha pyje qe shtrihen brenda kufijve territoriale te komunes, jane kryesisht prej pishë e bredhi , akacie, ahu e dushku. Flora natyrore ne keto siperfaqe eshte mjaft e pasur dhe me vlera te shumta perdorimi. Vecojme ketu bimet medicinale, aromatike e ato me vlera industriale.



BUJQESIA DHE BLEGTORIA

BUJQESIA

Bujqësia në komunën e Maqellares është si në të gjithë vendin ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë periudhës së tranzicionit. Gjatë periudhës së tranzicionit cila u shoqërua me demtime serioze të rrjetëve ujëtare dhe kulluese, të ndërtesave që i shërbenin prodhimit bujqësor, etj. Përdorimi i burimeve bujqësore ra në mënyrë drastike e cila sollti pakësimin e prodhimit bujqësor. Në kushtet e një kolapsi të plotë filloi zbatimi i reformave në bujqësi e cila përfundoi në vitin 1991. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm ishte reforma e tokës bujqësore që lejoi dhe krijim e fermave private. Karakteristike e këtyre fermave ishte madhësia shumë e vogël për sa i takon sipërfaqes së tokës, fragmentizimi i brendshëm i fermës në shumë pjesë, etj. Kjo pengon në një të konsiderueshme produktivitetin e tyre.

Toka bujqësore, me një sipërfaqe prej 2950 ha, është vendosur mbi një terren fushor dhe kodrinor me pjerresi të vogla.

Struktura e sipërfaqes së tokës e ndarë sipas prodhimit

Fshati	Toke Bujqësore (ha)			Livadhe kullota (ha)+ jonxhe
	Ara (ha)	Pemishte (ha)	Vreshta (ha)	
1 Maqellare	131	1	0.4	58.6
2 Burim	188	2	1	41
3 Potgorce	53	1.2	0.4	3.4
4 Çernene	59	2.5	0.5	26
5 Vojnike	146	1	0.6	94.4
6 Kovashice	102	1.5	0.4	57.1
7 Gradec				
8 Fushe e Vogel	86	1.3	1	30.7
9 Dovolani	132	6	0.3	54.7
10 Erebare	110	0.7	0.4	62.9
11 Herbel	79	2.6	0.4	32.6
12 Grazhdan	109	4.5	2	45.5
13 Popinare	36	4		24
14 Pesjake	47.5	2.6	2	10.9
15 Katund I Vogel	100.6	4.6	1	70.4
16 Pöcest	161	4.7	0.2	50.1
17 Kerçisht I Eper	61.5	3.8	-	33.7
18 Kerçisht I Poshtëm	98	1	0.3	25.7
19 Kllobçisht	190	5	0.2	62.8
20 Billate e Eper	37	1	0.2	2.8
21 Billate e Poshtëm	54	2	0.1	4.9
22 Majtare	91	1.5	-	34.5
TOTAL	2071.6	54.5	11.4	826.7

PRODHIMTARIA BUJQËSORE

Fshati	Drithëra		Produkte bujqësore			Fruta (t)	Vresht (t)	Foragjere
	Grurë(t)	Misër(t)	Të ndryshme perime (t)	Patate (t)	Fasule (t)			
1 Maqellare	115	50	30	60	3	80	16	4400
2 Burim	75	230	1200	30	16	110	35	1150
3 Potgorce	35	110	200	60	8	90	20	1000
4 Çernene	42	50	40	30	3	70	15	2000
5 Vojnike	75	100	80	30	6	80	15	4800
6 Kovashice	40	80	200	60	6	90	20	3600
7 Gradec								
8 Fushe e Vogel	40	100	100	60	6	100	30	2400
9 Dovolani	60	250	150	30	18	90	25	5300
10 Erebare	35	180	90	35	13	90	20	4500
11 Herbel	40	120	90	35	10	80	20	3300
12 Grazhdan	41	210	100	35	17	90	50	4600
13 Popinare		25	30	220	3	110	10	1500
14 Pesjake	40	50	60	30	3	80	50	1100
15 Katund I Vogel		150	100	190	13	140	15	4500
16 Pöcest	115	150	100	80	10	110	10	4800
17 Kerçisht I Eper	20	95	60	65	7	140	10	2100
18 Kerçisht I Poshtëm	70	150	150	60	10	130	15	2300
19 Kllobçisht	105	240	150	90	17	130	15	5500
20 Billate e Eper	30	70	60	30	5	60	10	630
21 Billate e Poshtëm	35	100	70	30	8	90	15	1100
22 Majtare	37	150	240	60	12	100	15	3000

BLEGTORIA


Gjate reformimit, krahas me token e shperndan blegtoria dhe asetete tjera si traktore, stalla etj. Megjithate ne krahasim me bujqesine mund te konsiderohet sektori qe u zhvillua me ritme me te shpejta gjate tranzicionit. Numeri I krereve ne pergjithsi ka ardhur duke u rritur nese I referohemi tabelës qe ben nje krahasim te vitit 2005 me ate te 2003. Ky zhvillim mund te shpjegohet me disa faktore si:

- Pershtatja e fermes se vogel per te rritur dhe blegtorine
- Shtimi i siperfaqeve me foragjere (ekzistenca e tokave per kullote, qe zene 150 ha ne komune)
- Shpenzime jo te medha per zhvillimin e gjese se gjalle
- Mundesia per sigurimin e mbijeteses se familjes
- Mundesia per te siguruar te ardhura gjate vitit
- Kerkesa ne rritje per produkte blegtorale, etj....

Pra, sikurse shihet dhe nga tabela, ka nje rritje te numrit te te imtave dhe gjedheve ne komune.

Sot ne komune numurohen rreth 6956 krere bageti, nga te cilat 5312 jane te imta dhe 5361 jane gjedh. Zhvillimi numerik eshte shoqeruar dhe me rritjen e prodhimeve blegtorale.

Vitet	Te imta		Gjedhe	Shpende
	Dele	Dhi		
2005	4128	1184	5361	19150
2003	3675	1020	4750	16870



Megjithate shihet si nje domosdoshmeri ngritja e nje baxhoje moderne per perpunimin e produkteve blegtorale. Aktualisht sapo ka filluar pune nje pike grumbullimi per perpunimin e produkteve blegtorale

Edhe ne te ardhmen sektori I blegtorise do te perbeje aktivitetin me te rendesishem ne aktivitetin prodhues bujqesor te komunes. Nga problemet kryesore te zhvillimit te blegtorise mund te permendim permiresimin racor, permiresimin e struktures se te ushqyerit, krijimi I kushteve te pershtatshme higjeno-sanitare, rritja e numrit te krereve ne cdo ferme, permiresimin e infrastruktures per perpunimin dhe tregtimin e produkteve blegtorale, etj...



Fshati	Te imta			Gjedhe	Shpende
	Qingja	Dele	Dhi		
1 Maqellare	385	428	4	364	1100
2 Burim	225	251	-	370	1800
3 Potgorce	126	140	-	161	850
4 Çernene	71	79	4	201	940
5 Vojnike	92	103	9	254	1250
6 Kovashice	99	110	15	195	750
7 Gradec	117	130	145	91	350
8 Fushe e Vogel	42	47	-	148	410
9 Dovolani	140	155	82	190	1300
10 Erebare	207	230	80	266	1100
11 Herbel	85	95	10	190	550
12 Grazhdan	126	140	145	304	670
13 Popinare	108	120	80	93	250
14 Pesjake	45	75	20	98	290
15 Katund I Vogel	135	150	105	247	450
16 Pocest	189	210	40	532	1600
17 Kerçisht I Eper	288	320	200	161	500
18 Kerçisht I Poshtem	324	360	15	328	1300
19 Kllobçisht	468	520	230	547	1800
20 Bllate e Eper	40	45	-	144	250
21 Bllate e Poshtme	162	180	-	239	800
22 Majtare	216	240	-	238	1200
SHUMA	3690	4128	1184	5361	19510

PRODHIMTARIA BLEKTORALE

Fshati	Delet			Dhitë		Lopët		Shpendët	
	Mish	Qumësht	Lesh	Mish	Qumësht	Mish	Qumësht	Mish	Vezë
1 Maqellare	32.5	17.1	0.64	0.02	0.3	837.2	480	1.1	90000
2 Burim	19	10	0.40	-	-	851	487.5	1.8	144000
3 Potgorce	10.6	5.6	0.21	-	-	370.3	212.5	0.8	67000
4 Çernene	6	3.2	0.11	0.02	0.3	462.3	271	0.9	72000
5 Vojnike	7.8	4.1	0.15	0.54	0.7	584.2	335	1.3	90000
6 Kovashice	8.4	4.4	0.16	0.90	1.2	448.5	211.5	0.7	63000
7 Gradec	9.9	5.2	0.19	8.70	11.6	209.3	120	0.3	27000
8 Fushe e Vogel	3.5	1.9	0.07	-	-	340.4	195	0.4	31500
9 Dovolan	11.8	6.2	0.23	4.92	6.5	437	250	1.3	90000
10 Erebare	17.5	9.2	0.34	4.80	6.4	611.8	350	1.1	90000
11 Herbel	7.2	3.8	0.14	0.60	0.8	437	250	0.6	45000
12 Grazhdan	10.6	10	0.21	8.70	11.6	699.2	400	0.7	50000
13 Popinare	9.1	4.8	0.18	4.80	6.4	213.9	122.5	0.2	18000
14 Pesjake	4.8	3	0.11	1.20	1.6	225.4	130	0.3	18000
15 Katund I Vogel	11.4	6	0.22	6.30	8.4	568.1	325	0.5	35000
16 Pocest	15.9	8.4	0.31	2.40	3.2	1223.6	700	1.6	125000
17 Kerçisht I Eper	24.3	12.8	0.50	12.00	16	370.3	212.5	0.5	40000
18 Kerçisht I Poshtem	27.3	14.4	0.54	0.90	1.2	754.4	432.5	1.3	99000
19 Kllobçisht	39	20.8	0.80	13.80	18.4	1258.1	720	1.8	135000
20 Bllate e Eper	3.7	1.8	0.06	-	-	331.2	190	0.2	18000
21 Bllate e Poshtme	13.7	7.2	0.30	-	-	549.7	315	0.8	65000
22 Majtare	18.2	9.6	0.36	-	-	547.4	445	1.2	90000
SHUMA	312.2	169.5	6.23	70.6	94.6	12330.3	7155	19.4	1,502,500

INFRASTRUKTURA DHE SHERBIMET

RRJETI RRUGOR

Rrjeti rrugor dhe transporti është një nga instrumentat që u nevojitet njëzë në prodhimin e mallrave dhe shërbimet. Nga pikpamja administrative rrjeti rrugor ka dy pronare: Ndermarrja e rrugëve rurale Diber e cila ka nën administrim 15 km rrugë rajonale si; Ura e Topojanit- Maqellare-Qenok (aksi rajonal Diber-Tiranë) dhe komuna që ka në administrim akseset rrugore komunale. Duke e konsideruar faktor të rëndësishëm rrjetin rrugor vitet e fundit janë bërë investime të rëndësishme në rrjetin rrugor rural duke përdorur fondet e buxhetit të shtetit, donatore të ndryshëm si dhe nga vete komuna. Qendra e komunes lidhet me qytetin e Peshkopisë nëpërmjet rruges nacionale Tiranë – Maqellare - Peshkopi dhe segmentit rrugor Bllate (dogana) - Maqellare. Akseset janë të asfaltuar dhe u shërben fshatrave të zonës sonë e më gjere, ndërsa pjesa tjetër e rrugëve është me kalldrem dhe zhavor si dhe rrugë dheu. Rreth 58 km rrugë auto lidhin fshatrat e komunes me qendrën e komunes dhe me rrugën nacionale. Ato janë të paasfaltuara. Ka përfunduar faza e parë e sistemim-asfaltimit të rruges Maqellare-Pocest dhe në fund të vitit 2007 përfundon e gjithë

rruga. Rrugët brenda fshatrave janë të kalldrema por me cilësi që lenë për të dëshiruar. Po të veshtrish me vëmendje hartën ku paraqitet sistemi rrugor i komunes Maqellare vëhet re se akseset kryesore të kësaj komune nuk i shërbejnë vetëm banorëve të fshatrave të Maqellareit por dhe fshatrave të tjera të komunave të tjera. Aktualisht aksin rajonal Maqellare-Peshkopi ka një intensitet të madh lëvizje me dy sense lëvizje Peshkopi-Maqellare-Bllate-Maqedoni dhe Peshkopi-Maqellare-Bulqizë Tiranë ku lëvizin makina të llojeve të ndryshme.




UJI I PIJSEM

Furnizimi me uje te pijshem te komunitetit, aktualisht perben nje prioritet per qeverisjen qendrore dhe ate vendore. Kjo shikohet jo vetem ne aspektin sasior por edhe ate cilesor dhe te dy lidhen drejtperdrejt me permiresimin e cilesise se jetes ne komune. Per furnizimin me uje te pijshem ne komune perdoren kryesisht dy menyra: me ujesjelles dhe cezma siperfaqesore. Furnizimi me uje te pijshem i popullsise se komunes realizohet nga Ujesjellesi i Madh i Maqellares i ndertuar me fonde te Dukattit



SKEMA E UJËSJELLËSIT



te Madh te Luksemburgut me vlere prej 4.3 milion euro, i cili furnizon me uje mbi 1250 familje ne 10 fshatra. Kurse per 12 fshatrat e tjere kane ujesjellesa per çdo fshat duke siguruar uje edhe per 1700 familje te tjera. Duhet theksuar fakti se edhe pse ne dukje eshte nje shifer e madhe dhe e kenaqshme e furnizimit me uje te pijshem ka plote probleme me furnizimin e tyre siç jane: furnizimi me orar i familjeve, furnizimi me cesma publike dhe ne disa raste keto ndodhen larg vendbanimeve.

KANALIZIMI I UJRAVE TE ZEZA DHE TE BARDHA

Kanalizimi i ujrave te zeza dhe te bardha eshte nje element i infrastruktures qe ka filluar te vleresohet sidomos ne vitet e fundit.

Menyra me e perhapur per sistemimin e ujrave te zeza ne fshatra eshte ajo me gropa septike individuale, mosfunksionimi i te cilave shpesh sjell rrjedhjen e tyre ne rruge. Edhe ne ato fshatra ku terreni favorizon per derdhjen e tyre ne perrenj, lumenj etj. Jane shfaqur probleme lidhur me mirembajtjen e tyre. Kanalizimi i ujrave te zeza eshte i pjesshem.

Ne komune funksionojne kanalizimet e ujrave te zeza, ne fshatrat Pocest, Grazhdan, jane ne perfundim ato te fshatrave Kllobçisht dhe Maqellare dhe jane projektet e perfunduara per fshatrat Kerçisht i Poshtem dhe Kovashice. Theksojme faktin se jane investuar ne zgjidhje te pjeseshme me kanalizime te ujrave te zeza ne fshatrat Burim, Bllate e Poshtme, Bllate e Eper dhe Pocest.

TELEKOMUNIKACIONI DHE SHERBIMI POSTAR

Ne komunen e Maqellareit eshte shume i perhapur komunikimi me rrjetin e levizshem telefonik. Ky realizohet si sherbim ne dhjete fshatra te komunes nepermjet telefonise celulare prej kompanive AMC e Vodafone. Shtrirja e telefonise celulare nuk do te thote se ka menjanuar nevojën per perdorimin e telefonise fikse. Sigurimi i familjeve rurale me lidhje telefonike fikse eshte bere e mundur qe ne vitin 2001 nga operatori rural "ALMA 2001" me afersisht 1100 abonente. Persa i perket sherbimit postar ne komune ekziston vetem nje poste, me 5 punonjes te cilet ofrojne sherbim postar Eëster Union dhe shperndarja e pensioneve per 1450 pensionist.

ENERGJIA ELEKTRIKE

Furnizimi me energji elektrike realizohet nga sistemi qendror i vendit dhe komuna Maqellare ka veresi te plote nga nenstacioni elektrik i Vojnikes. Vihen re probleme te ndryshme te cilat vijne si rezultat i ngarkeses se madhe ne kabinat kolektive elektrike si dhe nga amortizimi i rrjetit te brendshem shperndares te energjise. Fuqizimi dhe ndertimi i kabinave te reja per fshatrat dhe lagjet me problematike si dhe permiresimi i rrjeti shpernadres do te ishte nje nga prioritetet me kryesore ne kete fushe jo pak te rendesishme te jetes. Mungesa e energjise elektrike demton edhe biznesin i cili jep nje kontribut ne zhvillimin e zones.

QEVERISJA VENDORE

STRUKTURA E KOMUNES


Qe me 1991 me ndarjen e pushteteve, Maqellara eshte pjese e nivelit te pare te qeverisjes vendore si komune por qe kerkon te kete trajtim si bashki. Ajo ka administraten e cila emerohet nga kryetari i komunes i cili zgjidhet me votim te drejtperdrejte nga populli si dhe organin vendimarrës Keshillin Komunal qe zgjidhet nga lista emerore e keshilltareve mbi bazen e perqindjeve qe forcat politike qe i perfaqesojne, kane marre ne votimet per zgjedhjet lokale.

Gjithashtu cdo fshat ka dhe kryetarin e fshatit qe zgjidhet nga perfaqesuesit e cdo lagje.

Ne vitet e fundit jane krijuar dhe disa shoqata qe merren me ceshtje te caktuara si ajo e pyjeve, ujit te pijshem apo vadites e tj, si dhe eksistojne dhe komisione te ndryshme qe meren me nje problem te caktuar si I zgjidhjes se konflikteve, i pronave tej.

Komuna ka nje administrate me 19 punonjes. Kryetari, Zyra e Sherbimeve, Zyra e Finances, Zyra e Bujqesise, Zyra e Tatim Taksave, Zyra e Ndhimes Ekonomike, Zyra e Administrate –Arkivit, si dhe Policia Komunale.

Keshilli i Komunes perbehet nga 17 Keshilltare.



PERBERJA E KESHILLIT TE KOMUNES MAQELLARE

Ne zgjedhjet e dates 18 Shkurt 2007, perberja e Keshillit te Komunes Maqellare eshte sipas kesaj skeme.



A. AVANTAZHET/FUQITË

- POZITA GJEOGRAFIKE. Pozita gjeografike. Komuna Maqellare ka nje pozite te mire gjeografike e cila mundeson zhvillimin e bujqesise, blegtorise, biznesit si dhe te turizmit. Ajo eshte pika hyrese ne rrethin e Dibres, ka pike kalimi kufitar Dogana Bllate.
- PASURITE NATYRORE, toka fushore dhe pjellore, pyjet dhe kullotat, burimet ujore
- Burimet njerezore
- Te ardhurat financiare, (e komunes, personale dhe familjare, krahasura me Qarkun).
- Interesi per te investuar dhe qendruar ne Maqellare eshte i larte

B. DISAVANTAZHET

- Mungesa e infrastruktures se rrugeve te fshatrave.
- *Kapacitetet jo te mjaftueshem per thithjen e investimeve nga komuna*
- Mungesa e tregut ku te tregtohen produktet bujqesore dhe blegtorale.
- Teknologjia jo e zhvilluar e perpunimit te prodkuteve bujqesore dhe blegtorale.
- Mungesa e planit urban per qendren e Maqellares si dhe te akseve me te rendesishe, Maqellare -Bllate e Eper, Maqellare –Çernene.
- Fonde te kufizuar per te bere investime ne shume sektore.
- Sistemi i kreditimit pak i zhvilluar.
- Mungesa e mediave lokale.

C. MUNDESITE

- Politika qeveritare per Financime te ndryshme ne sistemim asfaltim rruges te fshatrave.
- Grantet konkruuese qe financohen nga Ministrite perkatese sipas natyres se investimit.
- Subvencionet nga ministria e Bujqesise per Fermeret
- Decentralizimi. Hapesirat qe jep ligji 8652 date 31.07.2000 ‘Per Organizmin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore’.
- Programi i Ambasades Hollandeze me Qarkun Diber
- Bashkepunimi nderkufitar me Dibren e Madhe.
- Levizja pa kufi e njerezve ne te dy anet e kufirit.
- Rritja e eficenses se punes se doganes per te levizur jo vetem njerzit por edhe mallrat.
- Rritja e ineresit nga kreditoret dhe donatoret e huaj.

D. RREZIQET

- *Politikat konjunkturale te tregut.*
- *Fenomeni i kriminalit, korupsionit dhe trafikut te paligjshem ne kufi*
- *Fenomenet e reja sociale dhe shoqerore.*
- *Ndotja e mjedisit*



VIZIONI DHE STRATEGJITE SEKTORIALE

VIZIONI:

Komuna e Maqellares ne 2013 do te jete nje njesi e madhe territoriale dhe administrative, me rruge te rregulluara, nje pjese e madhe e te cilave te asfaltuara, me rrjet ujesjellsash te perfunduar, me kanalizime te ujrave te zeza te perfunduara, me shkolla te rregulluara e me kushte normale per mesim, me Ambulanca per çdo fshat dhe me Qender Shendetesore ku ofrohet sherbim i kualifikuar dhe ne çdo kohe. E sitemuar nga ana urbane sipas normave dhe standartave te planifikimit urban, nje vend i mire per te punuar e jetuar per banoret e Maqellares por dhe per te tjeret te cilet do te vizitojne vendet turistike te tij, me bujqesi e blektori qe siguron te ardhura te mira per shume familje, me infastrukture te rregulluar ku njerezit ndihen krenar per traditen qytetare dhe kane mundesi te punojne te zhvillojne te ardhmen, duke shfrytezuar te gjitha mundesite, resurset dhe kapacitetet humane e financiare qe ofron Maqellara.

OBJEKTIVAT:

1. sigurimi i zhvillimit ekonomik lokal permes zhvillimit te bujqesise, blektorise, turizmit loka, i menaxhimit te mire te burimeve natyrore dhe biznesit.
2. permiresimi dhe ngritja e nje infastrukture te re dhe funksionale ne te gjithë territorin e komunes
3. sigurimi i nje zhvillimi te kenaqshem social, me kushte te mira per arsimin, shendetesine, kulturen, sportin etj.
4. fuqizimi i qeverisjes se mire lokale dhe shtimi i projekteve dhe aktiviteteve nderkufitare me Komunen E Dibres se Madhe (Maqedoni).



ZHVILLIMI EKONOMIK:

Zhvillimi ekonomik shihet ne 3 aspekte kryesore:

- zhvillimi i bujqesise dhe blegtorise
- menaxhimi i mire i burimeve natyrore
- biznesi

OBJEKTIVI 1:

Shtimi ne masen 20% i rritjes se te ardhurave dhe prodhimeve bujqesore dhe blektorale ne komune e Maqellares

Masat ne bujqesi:

- shtimi i siperfaqes se tokes se mbjelle me pemtari
- shtimi i siperfaqes se mbjelle me perime
- permiresimi i infastruktures vaditese
- permiresimi i mekanikes bujqesore
- sigurimi i asistences se nevojshme teknike
- rritja e bashkepunimit me Drejtorine e Bujqesise dhe ministrine e linjes, agjensite e huaja dhe donatoret.
- nxitja e krijimit te shoqatave sipas profileve te prodhimit

Masat ne Blektori:

- rritja e rendimentit te prodhimit te qumeshtit e mishit nga gjedhet, nepermjet permiresimit racor
- ofrimi i asistences se nevojshme teknike ne komune
- sigurimi i infastruktures se nevojshme
- nxitja e profilizimit te fermereve
- rritja e lobimit dhe promocionit per mbrotjen e prodhimit vendas.





Objektivi 2:
Rritja e te ardhurave nepermjet menaxhimit efektiv te burimeve natyrore

Masat:

- kalimi ne pronesi te komunes e pyjeve dhe kullotave qe jane ne teritorin e komunes
- hartimi i nje plani per zhvillimin e turizmit ne komune
- mbeshtetja e e shoqates se Pyjeve dhe kullotave komunale per zbatimin e planit te menaxhimit
- rritja e bashkepunimit me donatoret dhe me komunen e Dibres se madhe per mbrotjen e pasurive natyrore te perbashketa.
- Rregjistrimi i pasurive dhe pronave qe kalojne ne pronesi te komunes,

Objektivi 3:
Rritja e te ardhurave nepermjet zhvillimit te biznesit

Masat:

- Rritja dhe permiresimi i cilesise se sherbimeve ne bar-restorante, dyqane e tj.
- Rritja e numrit sherbimeve mekanike, elkotronike, pune me dore, parukerike etj.
- nxitja e hapjes se linjave perpunuese

- thithja e bankave, agjensive kredidhenese apo agjensi te tjera per te hapur aktivitetin e tyre ne komune.
- Sigurimi i te ardhurave lokale nga mbledhja me eficence e taksave
- Vendosja e sistemit te internetit per komunen dhe heqja e taksave lokale per te.
- Rritja e aftesive dhe sherbim me cilesor per biznesin nga administrada dhe vendimarresit e komunes.

INFASTRUKTURA

Objektivi:
Permiresimi i infastruktues ne masen 85% Brenda vitit 2013 per te gjithë teritorin e Komunes maqellare

Masat:

- Planifikimi profesional urban i komunes
- Menaxhimi i Ujit te pijshem
- Sigurimi i asfaltimit te me shume se 70% te rrugeve kryesore qe lidhin fshatrat e komunave me rrugen nacionale
- Sigurimi ne masen 90% i gjithë sistemit te ujerave te zeza per te gjithë fshatrat e komunes.
- Ndertimi i sitemit te menaxhimit mbetjeve urbane ne komune.
- Permiresimi i sistemit te komunikimit me telefoni fikse
- Energjine
- Shtimi i fondeve per mirembatjen e infastruktues

ZHVILLIMI SOCIAL

ARSIMI

OBJEKTIVI:
Rritja e cilesise se sherbimit arsimor per komunitetin e Maqellares.

Masat:

- rritja e investimeve per objektet arsimore, godina, mjete, laboratore, terrene sportive etj
- krijimi i kushteve te mira per transportin e nxenesve dhe mesuesve
- bashkepunim i mire me drejtorine Arsimore per zbatimin sa me te mira te politikave arsimore ne komune
- nxitja e komunikimit me komunitetin per te kontribuar ne rritjen e cilesise se shkollimit.

SHENDETSIA

Objektivi:
Rritja e cilesise se sherbimit shendetesor.

Si do te arrihet:

- rritja e investimeve per godinat dhe infrastrukturen shendetesore ne komune
- ofrimi i sherbimit shendetesor me cilesi dhe ne kohe per cdo fshat te komunes
- rritja e fondeve dhe kujdesit te komunes per sherbimin ne spitalin e komunes
- Permiresimi i kujdesit ndaj nenes dhe femijve
- Ngritja e konsultoreve ne ato fshatra qe mungojne
- Bashkepunim i mire me drejtuesit e shendetit publik ne komune dhe ne rajon.

SPORTI

Objektivi:
Rritja e vemendjes dhe mbeshtetjes per sportin

- Shtimi i investimeve dhe fondeve per terent dhe aktivitetet sportive.
- Nxitja e biznesit privat per hapjen e minifushave te futbollit me tapet
- Shfrytezimi me i mire i terreneve sportive ne shkolla
- Mbeshtetje per krijimin e ekipeve sportive qe perfaqesojne Maqellaren

MUZEUMI

Objektivi.
Krijimi i nje ambienti per te ekspozuar vlerat historike, kulturore, arkeologjike, folkloristike te zhvillimit te Komunes Maqellare ne shekuj.

QEVERISJA E MIRE LOKALE

Objektivi 1:
Rritja e cilesise se sherbimit ndaj qytetareve me aftesi profesionale, ne kohe duke menaxhuar me eficence dhe transparence fondet publike.

Masat:

- Krijimi i kushteve te pershtshme me ambiente dhe pajisje per stafin e komunes.
- Rritja e aftesive te punonjesve te administrades se komunes dhe vendimarrjesve te keshillit te komunes.
- Rritja e pjesemarrjes se komunitetit ne vendimarrje
- Rritja e bashkepunimit me te gjithe aktoret mbeshtetes te qeverisjes ne komune.

Objektivi 2:
Rritja e perpjekjeve per te krijuar modele te qendrueshme bashkepunimi nderkufitar me komunen e Dibres se madhe e me gjere me organizma te tjere te Maqedonise.

Masat:

- Shtimi i kontakteve dhe komunikimit ne menyre te strukturuar me komunen e Dibres se Madhe
- Rrotja e e njhurive dhe informacionit per bashkepunimin nderkufitar.
- Rritja e bashkepunimit me programet dhe projektete qe promovojne kete bashkepunim
- Rritja e rolit dhe bashkepunimit me shoqerine Civile ne Maqellare dhe ne Peshkopi.

LISTA E OBJEKTEVE DHE AKTIVITETEVE PRIORITARE SIPAS FUSHAVE:

FUSHA / SEKTORI	PROJEKTI OSE AKTIVITETI
ZHVILLIM EKONOMIK - Bujqesi - Blegtori - Biznes - Burimet natyrore	<ul style="list-style-type: none"> - Rikonstruksion i kanalit vadites te fshatit Bllate e Poshtme - Ndertim i kanalit vadites Kerçisht i Eper - Kerçisht i Poshtem Kerçisht i Eper -Kllobçisht - Venia ne pune kanali i Bllaces - Rezervuari i Popinares - 2 baxho per perpunimin e Qumeshtit - 4 linja perpunimi ushqimore dhe pijesh - Qendre nderzimi artificial - 2 fidanishte - 1 qender frikoriferike - 1 qender sherbimi dhe furnizimi bujqesore - Plan per zhvillimin e biznesit - Plan zhvillimi per Turizmin - Tregu i komunes - 2 panaire ne vit - 1 linje perpunimi mishi
INFASTRUKTURE - Rruge - Rrjete Ujesjellësish - Rrjete të K U Z	<ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i Planit Urbanistik per Komunen Maqellare. 2. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Kllobçisht 3. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Burim 4. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Kerçisht i Poshtem 5. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Kerçisht i Poshtem 6. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Kovashice 7. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Bllate e Eper 8. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Bllate e Poshtme 9. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Majtare(lagjia e Eper) 10. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Burim 11. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Kovashice 12. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Fushe e Vogel 13. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Vojnike 14. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Majtare 15. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Çernene 16. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Grazhdan 17. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Herbel 18. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Bllate e Poshtme 19. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Bllate e Eper 20. Riparim i ujesjellesit te fshatit Dovolani



	<p>21. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Kerçisht i Eper</p> <p>22. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Potgorce</p> <p>23. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Katund i Vogel</p> <p>24. Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Herbel</p> <p>25. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Erebare</p> <p>26. Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Dovolani</p> <p>27. Rikonstruksion i rruges Klllobçishi - Kerçenice-Kerçisht i Poshtem -Pocest(tek varrezat</p> <p>28. Ndertim i Ujesjellesit Katund i Vogel - Maqellare</p> <p>29. Ndertim i Zyrove per Komunen</p> <p>30. Riparim i ujesjellesit te fshatit Dovolani</p>
<p>ZHVILLIM SOCIAL</p> <p>- Arsim</p> <p>- Shendetesi</p> <p>- Sport</p> <p>- Kulture</p>	<p>31. Ndertim i shkolles se Mesme te Pergjithshme Maqellare</p> <p>32. Ndertim i shkolles se Ciklit te Ulet te fshatit Grazhdan</p> <p>33. Ndertim i shkolles se Ciklit te Ulet ne fshatin Potgorce</p> <p>34. Ndertim i Konsultores tip A-2 ne fshatin Grazhdan</p> <p>35. Ndertim i Konsultores tip A-2 ne fshatin Popinare</p> <p>36. Ndertim i Konsultores tip A-2 ne fshatin Pesjake</p> <p>37. Ndertim i Konsultores tip A-1 ne fshatin Maqellare</p> <p>38. Ndertim i Konsultores tip A-2 ne fshatin Fushe e Vogel</p> <p>39. Qender Kulturore (Muzeum, salle interneti, etj)</p>
<p>QEVERISJE E MIRE</p>	<p>40. Ndertim i Zyrove per Komunen</p> <p>41. Komiteti i bashkepunimit nderkufitar</p> <p>42. blerja pajisjesh per zyrat</p> <p>43. kontrate me njesine e trajnimit per rritje kapacitetesh</p> <p>44. plani operacional</p>

PRIORITETET E KOMUNES MAQELLARE

NR	LISTA E PRIORITETEVE	VLERA NE LEK	AFATI KOHOR
1.	Hartimi i Planit Urbanistik per Komunen Maqellare.		
2.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Klllobçisht	2.500.000	Mars 2008
3.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Burim	19.000.000	2008
4.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Kerçisht i Poshtem	12.800.000	2008
5.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Kerçisht i Poshtem	13.800.000	2008
6.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Kovashice	19.500.000	2008
7.	Ndertim i Zyrave per Komunen	18.700.000	2008
8.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Bllate e Eper	16.000.000	2009
9.	Ndertim i shkolles se Mesme te Pergjithshme Maqellare	6.000.000	2009
10.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Bllate e Poshtme	17.400.000	2008
11.	Ndertim i Konsultores tip A-1 ne fshatin Maqellare	21.500.000	
12.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Majtare(lagjia e Eper)	1.500.000	
13.	Ndertim i shkolles se Ciklit te Ulet te fshatit Grazhdan	6.000.000	2008
14.	Ndertim i Tregut te Maqellares	6.780.000	
15.	Ndertim i shkolles se Ciklit te Ulet ne fshatin Potgorce	4.500.000	2008
16.	Ndertim i Konsultores tip A-2 ne fshatin Fushe e Vogel	2.800.000	
17.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Burim	1.000.000	
18.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Kovashice	17.300.000	
19.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Fushe e Vogel	9.600.000	
20.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Vojnike	7.500.000	
21.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Majtare	14.200.000	
22.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Çernene	12.500.000	
23.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Grazhdan	9.500.000	
24.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Herbel	14.600.000	
25.	Ndertim i Konsultores tip A-2 ne fshatin Pesjake	1.000.000	



NR	LISTA E PRIORITETEVE	VLERA NE LEK	AFATI KOHOR
26.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Bllate e Poshtme	13.000.000	
27.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Bllate e Eper	7.000.000	
28.	Riparim i ujesjellesit te fshatit Dovoln	1.800.000	
29.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Kerçisht i Eper	6.700.000	
30.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Potgorce	5.800.000	
31.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Katund i Vogel	16.400.000	
32.	Ndertim i rrjetit KUZ ne fshatin Herbel	7.800.000	
33.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Erebare	9.200.000	
34.	Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Dovoln	21.500.000	
35.	Rikonstruksion i kanalit vadites te fshatit Bllate e Poshtme	4.600.000	
36.	Ndertim i kanalit vadites Kerçisht i Eper - Kerçisht i Poshtem Kerçisht i Eper - Kllobçisht.	7.000.000	
37.	Ndertim i Konsultores tip A-2 ne fshatin Grazhdan	1.000.000	
38.	Ndertim i Konsultores tip A-2 ne fshatin Popinare	1.000.000	
39.	Rikonstruksion i rruges Kllobçishi - Kerçenice-Kerçisht i Poshtem -Pocest (tek varrezat)	3.500.000	

REALIZUESHMERIA

Ky plan është i realizueshëm pasi mbështet mbi objektiva reale dhe mbi gjendjen reale ekzistuese. Ai bazohet mbi opinionet e të gjithë aktoreve potenciale lokal si dhe në modele të sukseshme të propozuar prej tyre. Gjithashtu në konsideratë janë marrë dhe opinione të specialistëve, objektivat e Mijevjeçarit dhe strategjia kombëtare e zhvillimit.

Ky plan do të realizohet nga:

Komuna Maqellare që është hartuese e politikave dhe programeve, nxitese, mbështetëse dhe zbatuese e shumë projekteve dhe aktiviteteve të këtij plani.

Komuniteti, që janë përfituesit, prodhuesit, investuesit kryesorë të këtij plani. Ata janë konsumatorë, fermerë, investues dhe kredi marrës për shumë aktivitete.

Shoqatat, të cilat do të ndihmojnë në menaxhimin efiçent të shumë burimeve dhe mundësive për secilin fushë perkatese të ekzistencës së tyre, të ujit, pyjeve, vreshtarise, pemtarise, rinise, sportit, artit etj.

Institucionet rajonale, të cilat do mbështetin, kordinojnë dhe harmonizojnë këto politika me ato rajonale dhe kombëtare.

Bashkëpunimi me fermeret, komunitetin, institucionet shtetërore si dhe organizata donatore financiare do të jetë çelësi i suksesit të këtij plani.

